

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar bashkërisht nga **Daimler Trak AG** (Daimler Truck AG), me seli në adresën Fasanenveg 10, 70771 Lajnfeld- Exterdingen, Gjermani, **TRATON SE**, me selinë adresën Dahayer Shtrase 641, 80995 Munih, Gjermani dhe **AKCIEBOLAGET VOLVO (PUBL)** (AKTIEBOLAGET VOLVO (PUBL), me selinë kryesore Gropegardsgatan 2, 405 08 Geteborg, Suedi, përmes personit të autorizuar Bozhidar Millosheviq, avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 02.02.2022, merr këtë:

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale e cila do të ndërtojë dhe operojë një rrjet karikimi elektrik publik me performancë të lartë të kamionëve elektrikë të rëndë dhe autobusëve transportues me bateri, nga Daimler Trak AG (Daimler Truck AG), me seli në Lajnfelden-Exterdingen, Gjermani, TRATON SE, me selinë adresën Dahayer Shtrase 641, 80995 Munih, Gjermani dhe AKCIEBOLAGET VOLVO (PUBL) (AKTIEBOLAGET VOLVO (PUBL), me selinë kryesore Gropegardsgatan 2, 405 08 Geteborg, Suedi, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 29.12.2021, i plotësuar më 05.01.2022 dhe më 24.01.2021, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim që i referohet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale e cila do të ndërtojë dhe operojë një rrjet

karikimi elektrik publik me performancë të lartë të kamionëve elektrikë të rëndë dhe autobusëve transportues me bateri, nga **Daimler Trak AG** (Daimler Truck AG), me seli në Lajnfelden-Exterdingen, Gjermani, **TRATON SE**, me selinë adresën Dahayer Shtrase 641, 80995 Munihi, Gjermani (përmes shoqërisë saj të varur TRATOM INTERNESHNAL S.A. (TRATON INTERNATIONAL S.A.) dhe **AKCIEBOLAGET VOLVO (PUBL)** (AKTIEBOLAGET VOLVO (PUBL), me selinë kryesore Gropegardsgatan 2, 405 08 Geteborg, Suedi (përmes shoqërisë së saj të varur VOVLVO ARENDAL AB, në të cilat kompanitë e përmendura do të kenë një pjesë të barabartë prej 33.3%, të drejta të barabarta proporcionale për shpërndarjen e të ardhurave dhe të drejta të barabarta për gazin.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Daimler Trak AG, me seli në Lajnfelden-Exterdingen, Gjermani, është 100% shoqëri e varur e Daimler Trak Holding AG (Daimler Truck Holding AG), kompani e cila kuoton në bursën e Frankfurtit. Daimler Truck është shoqëria mëmë që operon për aktivitetet e Daimler Truck Group në fushën e kamionëve dhe autobusëve të markës si Mercedes-Benz Trucks, Freightliner, Mitsubishi Fuso, Western Star dhe Setra.

Traton SE me seli në Mynih, Gjermani, kontrollohet në mënyrë të pavarur nga Volkswagen AG, me seli në Wolfsburg, Gjermani (VW Group / Volkswagen Group). Traton SE është një kompani holding për biznesin e kamionëve dhe autobusëve të Grupit Volkswagen. Operon kryesisht përmes njësive të saj operative MAN, Scania, Navistar dhe Volkswagen Caminjoes e Onibus (Volkswagen Caminhões e Ônibus).

Grupi Volkswagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusë transporti (coaches), shasi për autobusë dhe motorë me naftë, motoçikleta, duke përfshirë pjesë rezervë dhe pajisje shtesë për të gjitha kategoritë e automjeteve të përmendura. Grupi Volkswagen gjithashtu merret me shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen përfshin markat e automjeteve Volkswagen Passenger Cars, Volkswagen Light Commercial, Porsche, Audi, Shkoda, Lamborghini, SEAT, MAN, Scania dhe Ducati. Grupi Volkswagen është gjithashtu aktiv në fushën e shërbimeve të lidhura të automobilave, duke përfshirë shërbimet për shpërndarjen e makinave (*car sharina support*) dhe shërbimet dhe menaxhimin e flotave. Përmes brendit të tij Moia, ofron shërbime për shpërndarjen e makinave në Hamburg dhe Hanover.

Përveç kësaj, Grupi Volkswagen ofron shërbime financiare dhe sigurime në lidhje me shpërndarjen dhe financimin e makinave dhe automjeteve të tij komerciale, por gjithashtu mbulon aktivitete të rregullta bankare dhe të tjera sigurimesh. Kjo veprimtari realizohet kryesisht nëpërmjet Volkswagen Financial Services AG („FSAG”) dhe shoqëritë e tij të varura.

Në një masë shumë të kufizuar, Volkswagen Financial Services AG ofron gjithashtu shërbime të makinave me qira.

Grupi Volkswagen ka shoqëritë e varura të mëposhtme të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- Porsche Lising SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup, veprimtaria- Lising Financiar;
- Porsche Broker SHA Shkup, me seli në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup veprimtaria- përfaqësues në sigurim dhe ndërmjetësues sigurimesh;
- Porsche Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 4, Shkup, veprimtaria- tregtim me makina dhe mjete motorike të kategorisë së lehtë;
- Scania Makedonia SHPKNJP Ilinden me seli në Rrugën 34, nr. 7 Ilinden, Shkup me veprimtari- tregti me automjete të tjera motorike.

AKCIEBOLAGET VOLVO (PUBL) është një kompani shumëkombëshe me seli në Goteborg, Suedi dhe kuoton në bursën nordike Nasdaq OMX. Përmes hiseve të saj në Grupin e shoqërive Volvo, AKCIEBOLAGET VOLVO (PUBL) është globalisht aktive në prodhimin dhe shitjen e kamionëve për në autostradë dhe jashtë saj, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit dhe motorëve detarë, motorëve për në autostradë dhe jashtë saj dhe motorëve industrialë.

Grupi Volvo në Maqedoninë e Veriut ka të regjistruar një shoqëri të varur:

Shoqëria për tregti, shërbime dhe transport mallrash VOVLO MAKEDONIA Vtc SHPKNJP qojlija Petrovec me adresë në Petrovec Qojlija rr. 112 2/14 me veprimtari –mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike.

Ndërmarrja e përbashkët do të fokusohet për të qenë një Operator i stacionit/vendit të karikimit elektrik, i cili do të ndërtojë dhe operojë një rrjet të aksesueshëm nga publiku për karikim me performancë të lartë të kamionëve elektrikë të rëndë dhe autobusëve me bateri, përgjatë dhe afër autostradave kryesore dhe pikave logjistike me interes në vendet e zgjedhura dhe kontraktuese në Evropë, por jo në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e*

rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски